



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1023/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi, kryetar , Franciska Zhitia Ymeri dhe Dren Rogova anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP “Bleri” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike rivlerësim i mallit doganor, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1519/19, të datës 18.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.06.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1519/19, i datës 18.05.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1519/19, të datës 18.05.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP “Bleri” me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është anuluar aktvendimi me nr.01.3.2.2/5257 i datës 29.05.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTP “Bleri” me seli në Prishtinë, t’ia kthej shumën prej 2,246.92€ (dymijë e dyqind e katër dhjetë e gjashtë euro, e nëntëdhjetë e dy centë) të paguara më tepër në emër të detyrimeve doganore për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore ((DUD) me nr. R-3037/28.03.2019 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Merdare, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e pagesës së detyrimeve importuese doganore datë 28.03.2019 e deri në pagesën e plotë të kësaj shume.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta prishë si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar, ose t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i kësaj gjykate shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit

81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/5257 të datës 29.05.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë NTP “Bleri” me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit R-3037/28.03.2019, të ZBD Merdare, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.06.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/5257 të datës 29.05.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se gjykata vlerëson se e paditura në rastin konkret pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi përmes DUD-it nr.R-3037/28.03.2019 të ZBD Prishtinë dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 2,246.92€ mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar. Gjykata konstaton se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se e paditura do të mund ta mbështet një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor të importuar, i ka paguar eksportuesit “Master Frigo DOO” nga Beogradi-Serbia mbi çmimin e pro faturës së mallit me nr. P0748 të datës 27.02.2019 ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është 26,859.30 vlerë kjo edhe e paguar nga paditësi-importuesi i mallit, sipas transferit bankar të datës 28.02.2019 me përshkrimin “*avans për pagesë të faturës nr. P048*” në shumën prej 8,057.79€ dhe transferit bankar të datës 22.03.2019 me përshkrimin “*pagesë për faturën nr.P0748*” në shumë prej 18,801.51€ e që kur të mblidhet këto dy shuma japin vlerën e deklaruar të mallit lëndor në DUD prej 26,859.30€.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk i ka administruar provat për të vërtetuar gjendjen faktike, por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerrë konkluzion të gabuar duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe këtë e vërteton fakti se gjykata gabimisht ka konstatuar se e paditura nuk ka vërtetuar saktë gjendjen faktike, pastaj se, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar është theksuar se në deklaratën doganore të paditësit kanë qenë të bashkangjitura fatura dhe transaksioni bankar në tërësi të harmonizuara dhe në përputhje me nenin 123 të UA për Implementimin e KDAK-së, qëndrim ky i cili është i gabuar dhe jo i bazuar në dispozita ligjore. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë vazhdimisht në referatin e arsyetimit thekson se paditësi ka paraqitur dokumentacion të nevojshëm, si transferin bankar, faturën etj., mirëpo ky konstatim i gjykatës është i gabuar, sepse gjykata nuk jep asnjë arsyetim se përse paditësi ka deklaruar vlerë më të ulët nga ajo që ka konstatuar e paditura Dogana e Kosovës. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se e paditura me vendimin kontestues nuk ka dhënë arsye dhe prova konkrete se përse e ka kontestuar vlerën e mallit si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga paditësi, kur ka konsideruar se vlera e mallit lëndor e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin, me qëllim të importit në vendin tonë. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që tek e paditura mund të jenë zhdoganuar mallra të ngjashëm me mallin lëndor, me karakteristika të ngjashme por që kanë vlerë më të lartë të transaksionit se sa vlera e deklaruar e subjektit në procedurë, sepse me dispozitën ligjore të nenit 33 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuara duhet të jen të njëjtë me vlerën e mallrave të ngjashme të shitura për Kosovë, në një periudhë të afërt kohore, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit që paraqet çmimin vërtet të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur sipas nevojës në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësin, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*. Po ashtu paditësi në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ gjykatës si provë i ka dorëzuar edhe kontratën e shitblerjes të datës 20.03.2019 të lidhur me eksportuesin e të cilin provë gjykata e administroj pasi që sipas nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për Implementimin e KDAK-së nr.03/L-109 një dokument i tillë nuk është kërkuar që ti

bashkëngjitet deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar edhe bazën ligjore sa i përket dokumenteve që parashihet ti bashkëngjiten DUD-ave gjatë zhdoganimit të mallit, të cilat me të drejtë ka vlerësuar se provat e paraqitura nga paditësi janë në harmoni të plotë me dispozitat ligjore sa i përket vlerës së transaksionit për pagesën e faturës së mallit lëndor në kuptim të nenit 33 të KDAK-së.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë, dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave ligjore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë me anë të ekspertizës financiare gjyqësore, dhe sqarimit të saj.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, dhe anulimit të aktvendimit të kontestuar, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1023/22, me datë 02.06.2023

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari
Ramush Bardiqi